

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6548
E mërkurë, 2 mars 2022
çmimi 0.40 €

Kosova, kapacitete të kufizuara për strehimin e ukrainasve | FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

DITA E GJASHTË E LUFTËS NË UKRAINË | FAQE 4-5

NATO DHE PARLAMENTI EVROPIAN I KËRKOJNË RUSISË TËRHEQJEN E FORCAVE NGA UKRAINA



Lufta në mes të Rusisë dhe Ukrainës ka mbërritur në ditën e gjashtë të saj, duke kapërcyer tashmë në një fazë të re. Ushtria ruse ka shtuar bombardimet në Kharkiv dhe në qytete të tjera. Një autokolonë ushtarake ruse prej 60 kilometrash ka mbërritur aktualisht në portat e kryeqytetit ukrainas. Pavarësisht prej saj, presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, ka thënë se nuk do të thyhen nga forcat ruse. Ai para Parlamentit Evropian përmes një videolidhjeje ka theksuar se do ta mbrojnë vendin e tyre


OPINION



UNË E KAM 'ZELENSKYIN TIM'

F.7

Shkruan:
Astrit GASHI



AKTUALE



KONJUFCA: KOSOVA, PARTNERE E BESUESHME E BE-së F.5

GRATË TË PAPËRFAQËSUARA NË KËSHILLAT LOKALE: 733 KRYESUES, VETËM 7 JANË GRA F.7

EKONOMI



BORDI I AKP-SË APROVOI DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË 33 PRONAVE, RRIEN ÇMIMET OFERTUESE F.8

FILLON SHITJA ONLINE E POLICAVE KUFITARE F.8

PSD-ja vendos plugun para Ministrisë së Bujqësisë, kërkon subvencione për bujqit

FAQE 3



DORIS PACK: KOSOVA DUHET TË NJIHET MENJËHERË NGA PESË VENDET E BE-së

FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Kosova, kapacitete të kufizuara për strehimin e ukrainasve

PRISHTINË, 1 MARS - Qeveria e Kosovës nuk është deklaruar ende nëse është e gatshme të pranojë refugjatë nga Ukraina. Sipas Agjencisë së Kombeve të Bashkuara për Refugjatë, më shumë se 660 000 refugjatë i kanë ikur luftës në Ukrainë për të kërkuar strehim në shtetet fqinje, siç janë Polonia, Sllovakia, Hungaria, Moldavia, Rumania. Më 28 shkurt refugjatët e parë kanë arritur edhe në Serbi. "Numrat janë duke u rritur shpejt. Në këtë shkallë situata mund të kthehet në krizën më të madhe të refugjatëve në Evropë këtë shekull", ka thënë zëdhënësi i Agjencisë së OKB-së për Refugjatë, Shabia Mantoo, para gazetarëve në Gjenvë më 1 mars.

Qeveria e Kosovës ka dënuar pushtimin rus në Ukrainë dhe ka vendosur sanksione në linjë me ato të Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian. Në pakon e sanksioneve përfshihet ngrirja e asetëve të bankave, institucioneve financiare dhe individëve, ndalimi i tyre në tregje financiare dhe masa të tjera kufizuese që shënjestrojnë ndërmarrjet e rëndësishme ruse, elitat dhe aktorët politikë të përfshirë në marrjen e vendimit për pushtim rus në Ukrainë. Në pyetjen se a është duke e shqyrtuar qeveria pranimin e

refugjatëve nga Ukraina, zëdhënësi i Qeverisë së Kosovës, Përparim Kryeziu, ka thënë se Kosova është rreshtuar kah bota demokratike.

"Përveç solidarizimit ndaj shtetit të Ukrainës dhe popullit ukrainas, qeveria tashmë ka vendosur edhe sanksione ndaj Rusisë në linjë me sanksionet e Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara. Veprimet tona do të vazhdojnë të jenë në linjë me partnerët dhe aleatët tanë dhe në mbështetje të Ukrainës", ka thënë Kryeziu.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka deklaruar së fundi për mediet në Kosovë se vendi që ajo udhëheq është i gatshëm të pranojë refugjatë nga Ukraina në përputhje me kapacitetet që ka Kosova. Autoritetet e Kosovës kanë deklaruar më herët se Kosova ka kapacitet për strehim të deri 3 500 refugjatëve.

Behxhet Shala, drejtues i Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Prishtinë, thotë se Kosova nuk mund t'i mbyllë dyert për refugjatët ukrainas, por nuk ka kapacitete t'i strehojë për kohë të gjatë. "Vetëm nëse organizatat e huaja ndërkombëtare, Bashkimi Evropian apo ShBA-ja ndihmojnë në aspektin logjistik dhe material, Kosova mund të strehojë një numër simbolik të refugjatëve nga Ukraina, në të kundërtën nuk



ka kapacitete", thotë Shala. Kosova ka dy qendra të azilkerkuesve: një në Magurë të Lipjanit dhe një në fshatin Vranidoll të Komunës së Prishtinës. Këto dy qendra kanë kapacitet të vogël dhe në kushte optimale mund të pranojnë jo më

shumë se 100 persona. Kosova nuk është përballur me numër të madh të refugjatëve, por vendi kryesisht përdoret si transit për vende të ndryshme të Evropës.

Në vitin e kaluar Kosova ka ofruar qëndrim për gati 1 000 refugjatë

nga Afganistani. Refugjatët nga Afganistani janë vendosur në kampin Bechtel-Eenka në Ferizaj dhe në kampin Bondsteel po në Ferizaj.

Pranimin e refugjatëve nga Afganistani në Kosovë e kanë kërkuar Shtetet e Bashkuara.

Haradinaj i drejtohet Kurtit me pesë kërkesa pas situatës në Ukrainë



PRISHTINË, 1 MARS (ER) - Pas gjendjes në Ukrainë, kreu i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka kërkuar nga kryeministri i vendit, Albin Kurti, që të veprojë në lidhje me sigurinë kombëtare. Përmes një shkrimi në llogarinë e vet në "Facebook", Haradinaj ka paraqitur pesë kërkesa drejtuar Kurtit. Kërkesat përfshijnë çështjen e strategjisë për sigurinë e Kosovës, Ligjin dhe fondin për FSK-në, gazsjellësin amerikan dhe dialogun me Serbinë. "Kryeministër, koha është për veprim 1. Përfundojeni Strategjinë e Sigurisë së Republikës së Kosovës. 2. Sillni

në Kuvend amendamentet e Ligjit të FSK-së, me nenin për donacione. 3. Sillni në Kuvend projektligjin për Fondin për Donacione për FSK. 4. Rishikojeni vendimin tuaj për projektin e gazsjellësit amerikan dhe miratojeni të njëjtin, pasi që nuk është vetëm projekt ekonomik, por edhe i sigurisë. 5. Hiqni dorë nga dialogu i teknikëve dhe përcaktohuni në procesin e marrëveshjes finale për njohje reciproke në kufijtë ekzistues. Çdo hezitim e vonesë për të vepruar në këtë drejtim, është rrezikim i sigurisë së vendit, për çka do t'ju mbajmë përgjegjës!", ka thënë Haradinaj.

Bie numri i rasteve me Covid në Kosovë, për 24 orë 61 të infektuar

PRISHTINË, 1 MARS (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se prej 1 257 testeve, 61 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit është

shënuar një rast i vdekjes. Të martën janë shënuar 241 qytetarë, ndërsa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 221 498.

Në total numri i rasteve aktive me Covid është 1.696.

Në 24 orët e fundit janë dhënë 688 doza të vaksinës kundër Covid-19.

Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 813 440 doza të

vaksinës. Deri më sot 816 179 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Deri më sot janë dhënë 97 546 doza përforcuese dhe doza të treta të vaksinës kundër Covid-19.



Doris Pack: Kosova duhet të njihet menjëherë nga pesë vendet e BE-së

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 1 MARS - Ish-deputetja e Parlamentit Evropian, Doris Pack, ka kërkuar njohjen e Kosovës nga pesë shtetet të cilat ende nuk e kanë bërë këtë gjë. Sipas Packut, njohja e Kosovës nga Spanja, Greqia, Sllovakia, Rumania dhe Qipro duhet të bëhet menjëherë. "Kjo luftë kundër Ukrainës është një thirrje zgjimi për një politikë zgjerimi më të angazhuar, më efikase të BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor. Diktatori Putin po përdor ndikimin e tij në disa prej këtyre vendeve për ta dobësuar BE-në. Njohja e Kosovës nga pesë shtetet anëtare të mbetura, Spanja, Greqia, Sllovakia, Rumania dhe Qipro, duhet të bëhet menjëherë", ka shkruar në llogarinë e vet në "Facebook", Doris Pack, e cila ka kërkuar angazhim të Bashkimit Evropian në Ballkanin Perëndimor. Edhe ministri i Mbrojtjes, Armend

Mehaj, pas kërkesës për anëtarësim të NATO-s, ka kërkuar që të njihet pavarësia e Kosovës edhe nga pesë shtetet e BE-së që ende nuk e kanë njohur shtetin e Kosovës. Mehaj në një postim në llogarinë e vet në "Facebook" ka kërkuar nga qytetarët dhe diaspora, që të gjithë në rrjetet sociale të vendosin hashtagun #KosovoInNATO, #KosovoInEU. Ai ka kërkuar nga Sllovakia, Rumania, Greqia, Spanja dhe Qipro që ta njohin shtetin e Kosovës. "Qytetarë të dashur, bashkëkombës nga mërgata jonë kudo në botë, miq tanë ndërkombëtarë: Ju bëj thirrje si bashkëqytetar, bashkëkombës dhe mik i juaji, të ftoni, kudo që jeni dhe nga cilado pozitë që keni, miqtë tuaj spanjollë, grekë, rumunë, sllovakë dhe qipriotë, ta dëgjojnë të vërtetën e Kosovës dhe popullit tonë: Republika e Kosovës dhe populli ynë ndajnë vlera të përbashkëta euroatlantike të lirisë, të paqes dhe të



democracisë. Republika e Kosovës është partnere e besueshme, e këtë e kemi dëshmuar në vazhdimësi në secilin projekt të përbashkët në funksion të humanitetit, paqes, sigurisë, stabilitetit dhe demokracisë. Republika e

Kosovës, historikisht dhe kulturalisht, është pjesë e pandarë dhe e natyrshme e familjes evropiane", ka shkruar Mehaj.

PSD-ja vendos plugun para Ministrisë së Bujqësisë, kërkon subvencione për bujqit

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 1 MARS - Partia Socialdemokrate (PSD) ka zhvilluar të martën një aksion para Ministrisë së Bujqësisë. Zyrtarët e PSD-së para objektit të kësaj ministrie kanë vendosur një plug, ku është bërë thirrje për t'i ndihmuar bujqit me subvencione. "Plugu i papërdorur është rezultat i krizës nëpër të cilën po kalon bujku i Kosovës. Rritja e çmimit të produkteve ka prodhuar kriza socio-ekonomike. Për bujqun e Kosovës, tekta jetesa është vështirësuar nga rritja e çmimit të produkteve, mbjellja e tokës po bëhet e paleverdishme. Vetëm për një vit kostoja për mbjelljen e grurit është rritur për 98 për qind", është thënë në njoftimin e kësaj partie. Kjo parti ka theksuar se çmimi i plehut artificial për punët e vjeshtës është rritur nga 112 euro në 288 euro për hektar, për fazën e parë të pranverës nga 72 euro në 192 euro për hektar, kurse për fazën e dytë nga 56 euro në 144 euro për hektar.



"Çmimi i naftës është rritur nga 60 euro në 75 euro për hektar dhe i farave për mbjellje nga 132 euro në 156 euro për hektar. Pra kostoja e mbjelljes së një hektari

me grurë është dyfishuar. Në kohë krizash të rënda si kjo, qeveria duhet të jetë dora ndihmëse për prodhuesin vendor; së pari të sigurojë që

prodhimtaria të vazhdojë në mënyrë që të evitohet kriza potenciale e çmimit të grurit dhe, së dyti, duke siguruar që kostoja për rritjen e çmimit të

produkteve të shpërndahet progresivisht; kush ka më shumë paguan më shumë, e kush ka më pak paguan më pak", është theksuar në njoftimin e PSD-së.

Sipas PSD-së, Kosova me prodhimin e grurit plotëson vetëm 55 për qind deri në 60 për qind të nevojës së saj. "Rritja e çmimit të mbjelljes së grurit nënkupton zvogëlimin e prodhimit vendor të grurit e që do të na detyrojë të blejmë grurin nga jashtë. Me luftën që tashmë po zhvillohet në Ukrainë, çmimi i grurit në tregun ndërkombëtar pritet ta vazhdojë rritjen. Prandaj kërkesat tona të menjëhershme për të evituar një krizë shumë më të madhe në mungesë të grurit janë këto: 1. Heqja e akcizës në naftë për bujqësi; 2. Subvencionimi i së paku 25 për qind të çmimit të plehut artificial, i cili gati është trefishuar në çmim gjatë muajve të fundit; 3. Rritja e subvencioneve për bujqësi për 25 për qind", është theksuar në njoftimin e Partisë Socialdemokrate që drejtohet nga Dardan Molliqaj.

Osmani takohet me Erdoganin, pritet me nderime të larta shtetërore

PRISHTINË, 1 MARS (ER) - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, është pritur të martën me nderime të larta nga presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan. Osmani është duke qëndruar

në një vizitë zyrtare në Turqi, ku për disa ditë radhazi ka takuar liderët shtetërorë. Në njoftimin e presidencës turke thuhet se në takimin e Osmanit me Erdoganin janë adresuar të gjitha aspektet

bilaterale në mes të dyja vendeve. Presidentja Vjosa Osmani ka takuar të martën edhe kryetarin e Parlamentit të Turqisë, Mustafa Şentop, me të cilin ka biseduar për marrëdhëniet

shumëdimensionale, të cilat, sipas Osmanit, do të forcohen edhe më tej nga bashkëpunimi në shumë sfera, duke e llogaritur Turqinë partnere strategjike në shumë procese.





DITA E GJASHTË E LUFTËS NË UKRAINË

NATO dhe Parlamenti Evropian i kërkojnë Rusisë tërheqjen e forcave nga Ukraina

Lufta në mes të Rusisë dhe Ukrainës ka mbërritur në ditën e gjashtë të saj, duke kapërcyer tashmë në një fazë të re. Ushtria ruse ka shtuar bombardimet në Kharkiv dhe në qytete të tjera. Një autokolonë ushtarake ruse prej 60 kilometrash ka mbërritur aktualisht në portat e kryeqytetit ukrainas. Pavarësisht prej saj, presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, ka thënë se nuk do të thyhen nga forcat ruse. Ai para Parlamentit Evropian përmes një videolidhjeje ka theksuar se do ta mbrojnë vendin e tyre

EPOKA E RE**Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 1 MARS - Parlamenti Evropian të martën ka mbajtur seancë të jashtëzakonshme për situatën në Ukrainë. Kjo seancë ka nisur me një çast emocionues. Kur në sallë u shfaq një videomesazh nga presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, të gjithë pjesëmarrësit u ngritën në këmbë duke duartrokitur.

Presidenti që ndodhet në Kiev, adresa e saktë e të cilit nuk u bë me dije, ka thënë para eurodeputetëve se Ukraina po jep njerëzit më të mirë për të qenë vend i lirë dhe i barabartë me të tjerët. "Bashkimi Evropian do të jetë shumë i fuqishëm me ne, kjo është e sigurt. Pa ju, Ukraina do të jetë e vetme", ka thënë Zelensky para Parlamentit Evropian përmes videolidhjes. "Dëshmojeni që jeni me ne.

Dëshmojeni që nuk do të na lini. Dëshmojeni se jeni evropianë dhe që jeta do të fitojë ndaj vdekjes dhe drita do të fitojë ndaj errësirës. Lavdi Ukrainës!", ka thënë ai.

Zelensky ka thënë se ajo çfarë po ndodh në shtetin e tij është tragjedi dhe se ukrainasit janë duke luftuar për tokën e tyre, lirinë dhe jetën. "Askush nuk do të na thyejë, sepse ne jemi ukrainas", ka pohuar ai.

Presidenti ukrainas ka thënë se Rusia ka shënjestruar edhe fëmijë dhe 16 kanë vdekur vetëm një ditë më parë.

Presidentja e Parlamentit Evropian, Roberta Metsola, ka falënderuar të gjithë popullin e Ukrainës për qëndresën. Ajo ka bërë me dije se kandidatura e Ukrainës për në BE do të shqyrtohet. "Ne do të punojmë për të arritur këtë qëllim", ka thënë Metsola.

Presidenti i Këshillit të Evropës, Charles Michel, nga seanca e Parlamentit Evropian, i ka bërë thirrje Rusisë që të tërhiqet, të shkojë në shtëpi. Duke theksuar se lufta ka prekur tokën evropiane, ai tha se Rusia jo vetëm që ka shkelur ligjin ndërkombëtar dhe

demokracinë, por ajo po kryen terrorizëm.

Lideri bjellorus Alexander Lukashenko ka bërë me dije të martën se forcat e vendit të tij nuk do t'u bashkohen trupave ruse në pushtimin e Ukrainës, duke dhënë një rreze shprese se konflikti nuk do të zgjerohet.

Lukashenko, aleat i ngushtë i presidentit Vladimir Putin, e bëri të qartë se "ushtria bjelloruse nuk po merr pjesë dhe as nuk do t'i bashkohet ndonjë aksioni ushtarak".

Për luftën në Ukrainë ka reaguar sërish kryeministri britanik Boris Johnson, i cili mbajti të martën një takim së bashku me homologun polak Mateusz Morawiecki në Varshavë, lidhur me zhvillimet e fundit në luftën

Fillon procesi i deklarimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë

Prishtinë, 1 mars (ER) - Më 1 mars ka filluar procesi i deklarimit të rregullt vjetor të pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë. "Të gjithë zyrtarët e lartë publikë janë të obliguar ta bëjnë deklarimin e pasurisë së tyre në Agjencisë Kundër Korrupsionit nga

data 1 deri më 31 mars 2022. Deklarimit të rregullt vjetor të pasurisë do t'i nënshtrohen rreth 4 737 zyrtarë të lartë publikë", ka njoftuar AKK-ja. Në njoftimin e dërguar në institucionet publike, Agjencia Kundër Korrupsionit rikujton të

gjitha subjektet deklaruese se mosdeklarimi i rregullt i pasurisë nga zyrtarët publikë, konform obligimeve ligjore, detyron Agjencinë Kundër Korrupsionit që të paraqesë kallëzim penal në pajtim me nenin 430 të Kodit Penal. "Në lidhje me deklarimin e

rregullt vjetor të pasurisë, Agjencia Kundër Korrupsionit ka dërguar të gjitha informatat në institucionet publike dhe ka kërkuar që publikuarin e deklarimit të pasurisë ta plotësojnë me të dhënat e kërkuara në pajtim me



udhëzuesin e pranuar nga AKK. Agjencia Kundër Korrupsionit pranon vetëm formularët e kompletuar", ka njoftuar AKK-ja.

Rusi - Ukrainë. Gjatë takimit Johnson ka theksuar se tragjedia e parashikuar ndodhi dhe po shohim një fatkeqësi në kontinentin evropian. Ai ka theksuar se Putini ka nënvlerësuar dëshirën e ukrainasve për ta mbrojtur vendin e tyre dhe për këtë është i bindur se ai do të dështojë.

Ndërkaq shefi i NATO-s, Jens Stoltenberg, i ka bërë thirrje Rusisë që t'i japë fund luftës në Ukrainë dhe t'i tërheqë të gjitha forcat e saj. Gjatë takimit që pati me presidentin polak Andrzej Duda, Stoltenberg ka pohuar se aleanca nuk do të dërgojë trupa apo avionë luftarakë për ta mbështetur Kievin pasi nuk dëshiron të bëhet pjesë e konfliktit.

Udhëheqësit e Gjermanisë dhe Luksemburgut kanë shprehur mbështetjen e tyre për popullin e Ukrainës këtë të martë, gjatë një konference të përbashkët për medie në Berlin. Kancelari gjerman Olaf Scholz i kërkoi presidentit rus Vladimir Putin që t'i ndalojë menjëherë të gjitha operacionet luftarake, t'i tërheqë

të gjitha trupat ruse dhe të kthehet në dialog.

Delegacionet ruse dhe ukrainase këtë të mërkurë me shumë gjasë pritet ta zhvillojnë raundin e dytë të bisedimeve, me synimin për ta ndërmjetësuar paqen në mes të konfliktit. Një ditë më parë anëtarët e të dyja palëve u kthyen në kryeqytetet e tyre për konsultime pas pesë orë bisedimesh në Bjellorusi.

Sulmi i Moskës ndaj Ukrainës ka nisur në orët e para të 24 shkurtit.

Presidenti rus Vladimir Putin ka urdhëruar "operacion special" për ta çmilitarizuar Ukrainën. Veprimi i Kremlinit ka nxitur zemërim dhe është dënua në gjithë botën.

Shtetet e Bashkuara dhe aleatët janë përgjigjur me sanksione të ashpra kundër Moskës.

Ministri i Jashtëm rus po mbante fjalimin, diplomatët e injorojnë dhe largohen

Ambasadorët dhe diplomatët nga Evropa u larguan gjatë

fjalimit me video të ministrit të jashtëm rus Sergej Lavrov, në Konferencën e OKB-së për Çarmatimin në Gjenevë të martën. Një video e publikuar nga delegacioni francez tregonte dhjetëra zyrtarë që largoheshin nga dhoma, ndërsa Lavrovi e nisi fjalimin e tij. Ministri i Jashtëm rus Sergej Lavrov ka thënë në Konferencën e Kombeve të Bashkuara për Çarmatim në Zvicër se është koha që armët bërthamore amerikane që gjenden në Evropë, të nisen në shtëpi.

Në një fjalim të incizuar paraprakisht, ai ka thënë se Rusia është e gatshme të bisedojë për stabilitetin strategjik me Shtetet e Bashkuara, mirëpo ka paralajmëruar se Perëndimi nuk duhet të dërgojë objekte ushtarake në shtetet e ish-Bashkimit Sovjetik. Ai, po ashtu, ka ofruar një arsytim të ri për pushtimin rus në Ukrainë për ta parandaluar Ukrainën nga grumbullimi i armëve bërthamore.

Bilanci i humbjeve të forcave ruse në Ukrainë

5 710 trupa është bilanci i humbjeve të Rusisë në ditën e gjashtë të sulmit në Ukrainë. Lajmi është konfirmuar këtë të martë nga Ministria e Mbrojtjes e Ukrainës përmes një njoftimi zyrtar. Po nga i njëjti burim mësohet se në luftën ndaj Ukrainës, Rusia ka humbur 29 avionë, 29 helikopterë, 198 tanke, 77 artileri, 846 makina të blinduara, 24 makina me sistem lëshimi rakete, 2 anije, 305 makina, 60 tanke, 3 mjete ajrore, 7 makina të tjera.

Çfarë ndodhi gjatë orëve të fundit

Të paktën 70 ushtarë u vranë në një sulm të artilerisë ruse, kanë konfirmuar zyrtarët ukrainas. Punonjësit e urgjencës po përpiqen të gjejnë të mbijetuar. Qendra rajonale e Khersonit është e rrethuar nga trupat ruse. Ushtria ruse po vazhdon vazhdimisht avancimin në Kiev, me imazhet satelitore që tregojnë një rresht me makina të blinduara rreth 65 km të gjatë. Të paktën 10 persona u vranë dhe 35 u plagosën në sulmet me raketa nga forcat ruse në qendër të Kharkivit këtë të martë. Lajmin e dha këshilltari i Ministrisë së Brendshme të Ukrainës, Anton Herashchenko, i cili tha se sulmet vranë dhe plagosën dhjetëra persona në Kharkiv, qyteti i dytë më i madh i vendit me 1.5 milion banorë.



Konjufca: Kosova, partnere e besueshme e BE-së

PRISHTINË, 1 MARS (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të martën në takim përfaqësuesin special të BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog. Konjufca vlerësoi bashkëpunimin dypalësh dhe kontributin e Bashkimit Evropian për përparimin e arritur për zbatimin e reformave legjislativë të cilat i kontribuojnë procesit integruar dhe perspektivës

euroatlantike të vendit tonë. Duke e dënua pushtimin e paprovokuar të Ukrainës, Konjufca u shpreh se Kosova qëndron përkrah BE-së, NATO-s, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Mbretërisë së Bashkuar dhe mbarë botës demokratike, përfshirë edhe vendosjen e sanksioneve kundër Rusisë. Ai theksoi se Kosova është partnere e besueshme e BE-së, teksa Serbia u rreshtua në

anën e Putinit dhe me të njëjtën retorikë luftënxitëse vazhdon ta kërcënojë Kosovën.

Shefi i Zyrës së BE-së, ambasadori Szunyog, ka shprehur mirënjohje për frymën bashkëpunuese dhe ndarjen e vlerave të përbashkëta si dhe ka konfirmuar mbështetjen për punën e Kuvendit dhe agjendën evropiane të Kosovës.



Nxënësit në Skenderaj marrin vaksinën kundër Covidit

Skenderaj, 1 mars (ER) - Po vazhdon plani i vaksinimit kundër Covid-19 për fëmijët nën moshën 18 vjeç, me pajtim

të prindit, në luftën e përbashkët përballë pandemisë. Kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura, ka vizituar shkollën

“Shaban Jashari”, ku nxënësit po merrnin vaksinën kundër Covidit. “Interesim i shtuar i nxënësve për ta marrë vaksinën

dhe për të dalë fitues përballë këtij armiku. Vaksina është e sigurt dhe efektive”, ka thënë kryetari Nura.



Drejtorja e Inspeksionit në Gjilan garanton standard të ri të punës

GJILAN, 1 MARS (ER) - Drejtorja e Inspeksionit në Gjilan po vazhdon punën e rregullt për garantimin e një modeli dhe standardi të ri të punës.

Drejtoresha e Inspeksionit, Entela Hyseni, ka bërë me dije se javën që kaloi kanë

proceduar hartimin e procesverbaleve për objektet pa leje ndërtimi, inspektimin sipas kërkesave në vendpunishte dhe vizitat aty ku janë ndërprerë punimet më parë.


Ajo ka thënë se kanë zhvilluar

kontrolle rutinore në qendër dhe zonat periferike të qytetit.

“Kemi konstatuar në zona të ndryshme fillime të punimeve ndërtimore, pa u pajisur me lejen e posaçme nga organet kompetente. Mosrespektimi i urdhrat të Inspeksionit paraqet

shkelje të ligjit dhe ndëshkimet do të bëhen në bazë të ligjit 041 L-110 dhe 041 L-175 të MMPH. Në total kemi marrë 15 kërkesa për fillimin e punimeve në lokacione të ndryshme si dhe 10 kërkesa për ndërtim, ku punimet janë

aktualisht të ndalura. Vazhdojmë sigurimin e mbarëvajtjes së punës dhe koordinimit me të gjitha institucionet dhe aktorët përkatës”, ka thënë drejtoresha e Inspeksionit në Gjilan, Entela Hyseni.



Drejtorja e Inspeksionit në Mitrovicë liron hapësirën publike

MITROVICË, 1 MARS (ER) - Drejtorja e Inspeksionit, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, kanë ndërmarrë një aksion për lirin e hapësirës publike të një nga lokalet i cili shtrihet përgjatë rrugës “Mbretëresha Teutë”.

Inspektorët komunalë kanë bërë me dije se personi përgjegjës i këtij lokali ka bërë vendosjen e tarracës me dërrasa pa leje.

Pas inspektimit të realizuar nga inspeksioni i komunës, punimet janë ndërprerë dhe janë vendosur shiritat deri në marrjen e lejes nga drejtorja përgjegjëse.

Drejtorja e Inspeksionit ka njoftuar se do të vazhdojë lirin e hapësirave publike në mënyrë që këto hapësira të kthehen në gjendjen e mëparshme.



Kryetari i Kamenicës nënshkruan marrëveshjet për shërbime të energjisë

KAMENICË, 1 MARS (ER) - Kryetari i komunës së Kamenicës, Kadri Rahimaj, ka njoftuar se janë nënshkruar marrëveshjet

për shërbime të energjisë në mes të komunës së Kamenicës dhe Fondit të Kosovës për Efiçencën e Energjisë. Sipas tij, këto

marrëveshje janë për zbatimin e masave të efiçencës së energjisë në Gjimnazin “Ismail Qemali” në vlerë prej 183 026.98


eurosh dhe zbatimin e masave të efiçencës së energjisë në Qendrën për Punë Sociale në vlerë prej 117,083.42 eurosh.

NËN SHKRUEH:

ZBATIMI / MASAVE TË EFIÇENCËS SË ENERGISË NË QENDRËN PËR PUNË SOCIALE NË VLERË PREJ 117,083.42€

ZBATIMI / MASAVE TË EFIÇENCËS SË ENERGISË NË GJIMNAZIN “ISMAIL QEMALI” NË VLERË PREJ 183,026.98€

Unë e kam “Zelenskyin tim”



Shkruan: Astrit GASHI

Të ndjekur... Të sharë... Sapo kishin pirë nga një gllënjë guximi... Shtoheshin radhët. Ishin dhjetë... U bënë 100, u bënë një mijë, u bënë 13 mijë... Presidenti ynë lutej të xhumave për lirinë e çlirim... Adem Jashari e dërgoi zërin e pushkëve përtej oqeanesh... Nuk na njihnin presidentin e komandantin e Kosovës në ardhje...

Eh në shqiptarët nuk u larguam asnjëherë nga damka e zezë që Kaiserlingu i dikurshëm na quan hajdutë fisnikë të përjetshëm. Akuza është e rëndë po të marrim parasysh se ishte një nga filozofët politikë më origjinalë e më të shquar të Gjermanisë pas

luftës. Prandaj gjykimin e tij duhet ta studiojmë me seriozitetin e duhur, me gjak të ftohtë dhe pa ndjenjën e një pseudo-patriotizmi romantik, e cila nuk ka më vend në kohën e sotme. Vetëm duhet studim me kokë të ftohtë. Pa vlerësuar dhe nderuar veten tënde dhe kombin tënd nuk mund të vlerësosh askënd.

Sot na gjykohej lira dhe vlerat e luftës sonë, gjykohej tri shkronjat e arta që na sollën lirinë tonë kolektive. Madje pa fije turpi ata që ishin në vijën e parë të fronit bëjnë selfie si të dehur nga pushimet e tyre të mundësuar nga sakrificat e këtij populli! Sot janë ata, nesër je ti..., gjeneral, veteran, politolog, mund të quash veten si të duash, por lufta jote ende s'ka mbaruar. Dje të njoha luftëtar, sot je dezertor...

Sot secili atdhetar dhe idealist ka plagë të hapur në trupin e tij. Sot ajo plagë po gjykohej në Hagë, e sponsorizuar nga Rusia dhe Serbia e miratuar nga Këshilli i Evropës. Pra, kjo Evropë e votoi



një raport të përbërë nga dezinformata ruse, i bazuar nga media si 'Spotnik' dhe 'Russia Today' që sot u ndaluan... komedi tragjike...

Sot jam me popullin ukrainas sepse kujtoi dy dekada me parë Drenicën time, i kuptoj se si

vuajnë luftën, tmerrin dhe krimet e Putinit dhe aparatit të tij sundues, por Perëndimi duhet të jetë përgjegjës për vonesat për ta armatosur Ukrainën të cilën e futi në rrugë pa krye.

Shkaktarët kryesorë janë Këshilli i Evropës dhe presidenti i

çmendur i Rusisë. Kush do ta paditë Këshillin e Evropës dhe Rusinë në Tribunalin e Hagës që për interesa politike përdorin popullin e Ukrainës i cili paguan faturën për politika të çmendura të tyre.

Stop luftës!

Gratë të papërfaqësuar në këshillat lokale: Nga 740 kryesues, vetëm 7 janë gra

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 1 MARS - Lëvizja Fol, me mbështetjen financiare të 'Rockefeller Brothers Fund', ka mbajtur të martën konferencë për medie, në të cilën ka publikuar monitorimin e raportit "Komunat nuk zbatojnë udhëzimin administrativ të MAPL-së nr. 02/2019". Fol ka monitoruar nivelin e implementimit të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale si dhe Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr. 02/2019 për Organizimin, Funkcionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane ku në mënyrë të hollësishme është shtjelluar çështja e përzgjedhjes së këshillave lokale.

Ardi Shatri ka thënë se, sipas udhëzimit administrativ në fuqi, komunat duhet të miratojnë rregullore të reja komunale për rregullimin e këshillave lokale në përputhshmëri me kërkesat e këtij udhëzimi administrativ brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e tij. "Sipas monitorimit të Fol, nga 38 komunat e Kosovës, 14 komuna (Prizren, Pejë, Ferizaj, Gjakovë, Mitrovicë, Skenderaj, Kamenicë, Hani i Elezit, Lipjan, Klinë, Kaçanik, Viti, Klokot, Graçanicë) i kanë të publikuara në uebfaqet e tyre zyrtare versionet e reja të rregulloreve komunale për organizimin dhe funksionimin e këshillave lokale, të cilat janë në

përputhshmëri me kërkesat e udhëzimit administrativ në fuqi", ka thënë ai, duke shtuar se nga komunat që i kanë publikuar rregulloret e reja, vetëm dy komuna (komuna e Gjakovës dhe komuna e Pejës) janë duke e implementuar plotësisht rregulloren e re në praktikë.

Ndërkaq 13 komuna (Deçan, Istog, Dragash, Obiliq, Leposaviq, Rahovec, Prishtinë, Suharekë, Vushtrri, Glogoc, Podujevë, Gjilan dhe Novobërdë) janë duke funksionuar me rregulloret e vjetra, që nuk janë në përputhshmëri me udhëzimin administrativ në fuqi. Sipas Shatri, 11 komuna (Fushë-Kosovë, Partesh, Shtime, Shtërpçë, Zveçan, Zubin Potok, Mitrovicë e Veriut, Junik, Mamushë, Malishevë, Ranillugë) nuk kanë publikuar asnjë version të rregulloreve. "Komunat të cilat kanë publikuar rregulloren e re komunale në përputhshmëri me kërkesat e udhëzimit administrativ janë komuna e Mitrovicës, e Gjakovës dhe ajo e Pejës", ka bërë me dije ai, ndërkaq komuna e Podujevës ka treguar se rregullorja gjendet ende në fazën e konsultimit publik. "Komuna e Gjilanit e ka të publikuar rregulloren e vjetër komunale që nuk është në përputhshmëri me kërkesat e udhëzimit administrativ", thotë ai.

Shatri ka thënë se sa i përket



statusit të përzgjedhjes së këshillave lokale, sipas të dhënave të dërguara nga zyrtarët përgjegjës të komunave, nga gjithsej 38 komunat e Kosovës, 18 prej tyre (apo 47 për qind) i kanë themeluar këshillat lokale të cilat janë duke funksionuar normalisht, 8 komuna (apo 8 për qind) kanë raportuar që këshillave lokale u ka kaluar mandati, apo se ende nuk janë zgjedhur, kurse 12 komuna (apo 31 për qind) nuk kanë kthyer

fare përgjigje rreth statusit të themelimit dhe funksionimit të këshillave lokale.

Sipas të dhënave të siguruar nga Fol, nga 740 kryesuesit e zgjedhur të këshillave lokale, 733 prej tyre, apo 99 për qind janë burra, kurse vetëm 7 janë gra (përkatësisht vetëm 1 për qind). "Komunat të cilat kanë zgjedhur kryetare gra të këshillave lokale janë: Komuna e Pejës (me tri gra kryetare të këshillave), komuna e Shtimes dhe komuna e Prizrenit (me nga

dy gra kryetare të këshillave)", ka thënë Shatri.

FOL i ka rekomanduar Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal që të koordinohet me Asociacionin e Komunave të Kosovës rreth aprovimit të rregulloreve të reja komunale për përzgjedhjen e këshillave lokale, si dhe themelimin dhe funksionimin e këshillave lokale në përputhshmëri me rregulloren komunale, udhëzimin administrativ dhe Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Bordi i AKP-së aprovoi dhënien në shfrytëzim të 33 pronave, rriten çmimet ofertuese

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 1 MARS - Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) ka mbajtur mbledhjen e radhës, në të cilën ka marrë vendime të rëndësishme për procesin e privatizimit dhe të likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore në përputhje me mandatin e vet ligjor.

Bordi i AKP-së ka miratuar rregulloren për rregullat e përgjithshme të tenderit dhe procedurave të shitjes me tender publik. Po ashtu, Bordi i AKP-së ka ratifikuar vendimin emergjent të bordit të datës 15 shkurt të këtij viti për konstituimin e bordit të përkohshëm menaxhues të ndërmarrjes "Agrokosova Holding".

Gjatë kësaj mbledhjeje menaxhmenti i AKP-së ka raportuar para bordit për aktivitetet e fundit të AKP-së, si dhe ka raportuar për pasqyrat financiare të buxhetit vjetor të agjencisë për vitin kalendarik 2021 dhe pasqyrat financiare të fondeve në mirëbesim të agjencisë për vitin kalendarik 2021.

Bordi i AKP-së ka miratuar

listat përfundimtare të punëtorëve për 20 për qind të të ardhurave nga shitja, transferimi ose likuidimi për ndërmarrjet shoqërore: N. Sh. "Fapol" në Podujevë, N. Sh. "Apiko" në Deçan, N. Sh. "Ekonomia e Pyjeve" në Prishtinë, pastaj për ndërmarrjen N. Sh. KB "Pirana" në Prizren dhe për ndërmarrjen shoqërore "Stacioni i Veterinës" në Rahovec.

Bordi i AKP-së, po ashtu, ka miratuar shpërndarjen e pjesës 20 për qind të të ardhurave nga shitja, transferimi ose likuidimi për listat përfundimtare të punëtorëve (që kanë punëtorë të miratuar) për ndërmarrjet: N. Sh. "Fapol" në Podujevë, N. Sh. "Apiko" në Deçan, N. Sh. "Ekonomia e Pyjeve" në Prishtinë, për ndërmarrjen N. Sh. KB "Pirana" në Prizren dhe për ndërmarrjen shoqërore "Stacioni i Veterinës" në Rahovec.

Bordi i AKP-së ka autorizuar menaxhmentin që, sipas procedurave ligjore në fuqi, ta bëjë shpërndarjen e mjeteve nga 20 për qind për këto ndërmarrje.



Ky bord ka shqyrtuar edhe çmimet e ofruara përmes ofertimit nga qiradhënia e aseteve (likuidim) përmes rishpalljes publike, ku për 33 asete aprovoi qiradhëniet duke vlerësuar se janë arritur rezultate më të mira sa i përket çmimeve të ofruara krahasuar me shpalljen e mëparshme si rezultat i një marketingu më të zgjeruar të ndërmarrjeve nga agjencia.

Ndërkaq u refuzuan ofertat e pranuar për 15 asete, për shkak të ofertave me çmime të ulëta, të cilat do të ritenderohen në të ardhmen njëjtë sikur edhe 20 asete për të cilat nuk pati oferta.

Bordi i AKP-së ka aprovuar raportet e shpërndarjeve të pjesshme për kreditorët e ndërmarrjeve shoqërore: N. Sh. IAC "Bujqësia" në Pejë; N. Sh. NS.T Autoshtëpia

"Mustafë Rexhepi" në Ferizaj; N. Sh. NHTT "Pashtriku" në Gjakovë; N. Sh. "Ratko Mitroviç-Kulla" në Prishtinë, për N. Sh. KB "Fryti" në Lipjan dhe për ndërmarrjen shoqërore "Fapoli" në Podujevë.

Bordi u njoftua edhe për propozimin e raportit përfundimtar (të mbylljes) për ndërmarrjen shoqërore "Kluz" në Prishtinë.

Fillon shitja online e policave kufitare



PRISHTINË, 1 MARS (ER) - Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) ka njoftuar se nga 1 marsi ka filluar shitja online e policave të sigurimit kufitar. Drejtori i BKS-së, Sami Mazreku, ka thënë se shitja online është një lehtësi e madhe për bashkatdhetarët, pasi ata, sidomos gjatë kohës së verës, kur kolonat në kufi janë të gjata, nuk kanë nevojë të presin fare për policë sigurimi, pasi mund të paguajnë ende pa u nisur.

Qytetarët që dëshirojnë të blejnë policë online duhet të klikojnë në këtë vjeggz <https://api.bks-ks.org/policaonline>.

Sipas drejtorit Mazreku, qytetarët gjatë blerjes online të policës kufitare duhet të jenë të kujdesshëm me rastin

e përzgjedhjes së kategorisë së mjeteve të përcaktuara sipas destinimit. "Në qoftë se kontraktuesi i sigurimit ka bërë me dashje, apo nga kujdesia lajmërimin e pasaktë ose e ka lënë në heshtje ndonjë rrethanë të një karakteri të tillë, sa që siguruesi nuk do të lidhte kontratën po të kishte ditur për gjendjen e vërtetë, kontrata e sigurimit do të jetë e pavlefshme", ka thënë Mazreku.

Ai ka bërë me dije se një policë kufitare të jetë e vlefshme ajo duhet të figurojë në regjistrin online në faqen zyrtare të Byrosë Kosovare të Sigurimit sipas të dhënave përmbajtjesore të cilat duhen plotësuar me rastin e kontraktimit të policës.

Paga minimale pritet të jetë rreth 250 euro

Prishtinë, 1 mars (ER) - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, ka paralajmëruar se paga minimale në Kosovë do të rritet në 250 euro. Megjithatë, ai ka thënë se e njëjta nuk duhet të jetë pengesë për krijimin e vendeve të punës për punëtorët me

produktivitet të ulët. Në prezantimin e studimit "Perspektiva e përgjithshme: Agjenda Progressive Ekonomike për Kosovën" nga Zyra e Fondacionit Gjerman "Friedrich Ebert" (FES), Bislimi ka thënë se grupet që diskutojnë për pagën minimale duhet të jenë

ekspertë dhe jo grupe të interesit. "I kuptoj shqetësimet për pagën minimale. Modeli që keni hartuar është pothuajse 100 për qind në përputhshmëri me objektivat e qeverisë. Mendojmë se paga minimale duhet të jetë rreth 250 euro", ka thënë Bislimi.



Të gjithë po jetojmë në “botën” e Vladimir Putinit

Nga Ivan KRASTEVE

Gazetarët që shkruanin mbi çështjet ndërkombëtare në vitet 1920-1930 e quajtën atë epokë si “paslufta”. Ata i analizuan ngjarjet përmes prizmit të Luftës së Madhe, e cila e kishte shkatërruar Evropën vetëm disa vite më parë. Historianët që shkruajnë sot i referohen po këtyre viteve si periudha “midis 2 luftërave”, për arsyen e thjeshtë se ata analizojnë atë që ndodhi gjatë atyre viteve si pjesë e shkuarjes drejt Luftës së Dytë Botërore, e cila ishte akoma më shkatërruese.

Sikur gazetarët që shkruanin në Evropën e viteve 1930, të kishin qartësinë e të kuptuarit të asaj që do të ndodhte më vonë! Sot këtë qartësi duhet ta kemi të gjithë. Sulmi ushtarak i Rusisë në Ukrainë, është një nga ato momente që na nxit ta ri-interpretojmë epokën tonë: atë që ne e quajmë paqen 30-vjeçare që pasoi Luftën e Ftohtë (me tendencën për të harruar, me vetëdije ose pa vetëdije, luftërat në ish-Jugosllavi) dhe që tani ka përfunduar.

Historianët e ardhshëm do t'i shohin dekadat e fundit në përgjithësi, një lloj si ata në periudhën ndërmjet 2 luftërave, si një mundësi të shpërdoruar. Sa më shpejt ta pranojmë këtë të gjithë, aq më mirë do të mund të përgatitemi për atë që do të vijë më pas.

Mjerisht, një mohim tejet egoist që përshkon kryeqytetet perëndimore, po na pengon të shohim atë që është e dukshme. Lutjet pasionante për të mbrojtur rendin evropian të pas Luftës së Ftohtë nuk kanë asnjë kuptim, pasi ajo epokë ka mbaruar.

Në vazhden e pushtimit të Krimesë nga Rusia në vitin 2014, Angela Merkel, që në atë kohë ishte kancelare e Gjermanisë, bisedoi me presidentin rus Putin, dhe më pas i raportoi presidentit amerikan Barack Obama se sipas saj, Putin e kishte humbur kontaktin me realitetin.

“Ai jeton në një botë tjetër!” - i tha ajo. Ndërkohë sot të gjithë ne po jetojmë në “botën” e tij. Në këtë botë, ku sipas Tukididit “të fortët bëjnë atë që mundën, dhe të dobëtit vuajnë atë që duhet të vuajnë”. Po si arritëm në këtë pikë?

Së pari, duhet të kuptojmë se kjo nuk është lufta e Rusisë, por e Vladimir Putinit. Ai vjen nga një brez i caktuar zyrtarësh rusë të sigurisë, të cilët nuk arritën asnjëherë të pajtoheshin me humbjen e Moskës në Luftën e Ftohtë. Në sytë e tyre, Bashkimi Sovjetik u zhduk nga harta pa humbje ushtarake apo ndonjë pushtim të huaj.

Për ta, sulmi aktual ndaj Ukrainës është një akt logjik dhe i domosdoshëm. Perandoria ruse mund të rikrijohet sërish. Këta njerëz nuk janë të interesuar që të



shkruajnë të ardhmen, ata duan ta rishkruajnë të shkuarën. Pushtimi i Putinit, mund të jetë më shumë për hakmarrje sesa një strategji madhështore.

Ka një dallim themelor midis revizionizmit dhe revanshizmit. Revizionistët dëshirojnë të ndërtojnë një rend ndërkombëtar sipas dëshirës së tyre. Revanshistët motivohen nga ideja e shpagimit. Ata nuk ëndërrojnë ta ndryshojnë botën, por të ndërrojnë vendet me fituesit e luftës së fundit.

Nëse Putin do të ketë sukses sot, Perëndimi mund të fajësojë për këtë vetëm veten. Ndërsa opinioni publik perëndimor e hipnotizonte veten me idenë se Rusia është në rënie të madhe, presidenti rus nisi që të realizonte strategjinë e tij.

Për vite me radhë, ai e konsolidoi sferën e tij të ndikimit mbi ish-Bashkimin Sovjetik, duke filluar me luftën e tij kundër Gjeorgjisë në vitin 2008, dhe aneksimin e Krimesë në vitin 2014. Kohët e fundit, ai ka forcuar kontrollin e tij në Bjellorusi dhe Azinë Qendrore. Tani ka ndërmarrë hapin e radhës dramatik.

Presidenti amerikan Xho Bajden, deklaroi të enjten se synon ta bëjë Putinin të duket një “udhëheqës i pabesë në skenën ndërkombëtare”. Ky do të ishte një dënim i përshtatshëm për këtë shkelje të së drejtës ndërkombëtare, por gjërat mund të mos funksionojnë në këtë mënyrë.

Përkundrazi, ekziston rreziku real që Perëndimi ta shohë veten më të izoluar. Gjatë 2 muajve të fundit, aleanca Moskë-Pekin ka kaluar nga hipoteza në realitet,

falë synimit të përbashkët për të sfiduar dominimin amerikan.

Ndërsa elitat kineze nuk janë të entuziazmuara për pushtimin e pamatur të Ukrainës nga Rusia (kinezët ruajnë përkushtimin e tyre për mos-shkeljen e sovranitetit të shtetit), nuk ka dyshim se ata do të qëndrojnë në anën e Moskës. Shihni sesi Pekini refuzoi ta përshkruante zyrtarisht si një pushtim luftën e Putinit.

Presidenti Xi Jinping mund të jetë përfutuesi më i madh i krizës aktuale: Amerika jo vetëm që duket e dobët, por tani e gjen veten të zënë me krizën në Evropë, dhe të paaftë për t'u fokusuar në Azi. Shumë vende e shohin konfliktin midis Rusisë dhe Perëndimit, si një konflikt midis imperialistëve të vjetër, dhe që vështirë se i prek ata.

Një shqetësim më i madh dhe emergjent, është mënyra se si sanksionet e vendosura nga Perëndimi, do të rrisin çmimet e energjisë dhe ushqimeve. Perëndimi mund të fitojë mbi skeptikët e përpjekjeve të tij për të luftuar kundër Putinit, vetëm nëse arrin t'u tregojë vendeve jashtë Evropës se ajo që është në lojë në Kiev, nuk është fati i një regjimi properëndimor, por sovraniteti i një shteti të sapolindur nga një perandori.

Po çfarë do të thotë fundi i paqes për Evropën? Pasojat do të jenë të tmerrshme. Lufta në Ukrainë ka potencialin e frikshëm të riaktivizimit të konflikteve të ngrira në periferinë e kontinentit, përfshirë hapësirën post-sovjetike dhe atë në Ballkanin Perëndimor.

Udhëheqësit e Republika Srpska, mund ta lexojnë një fitore të

Putinit në Ukrainë, si një sinjal për të shpërbërë Bosnjën. Edhe udhëheqësit brenda BE-së, që kanë një qasje me miqësore ndaj Rusisë, do të ndihen më të inkurajuar nga fitorja e Putinit. Pushtimi i Ukrainës e ka bashkuar Evropën, por ai do të dëmtojë vetëbesimin e saj.

Por ngjarjet e ditëve të fundit, do të kërkojnë një rishikim radikal të projektit evropian. Gjatë 30 viteve të fundit, evropianët e kanë bindur veten se forca ushtarake nuk ia vlenë për koston që kërkonte, dhe se epërsia ushtarake amerikane mjaftonte për t'i bërë vendet e tjera të hiqnin dorë nga ideja e luftës.

Shpenzimet për mbrojtjen ranë ndjeshëm. Ajo që kishte rëndësi, ishte fuqia ekonomike dhe fuqia e butë. Po tashmë e dimë se sanksionet nuk mund t'i ndalojnë dot tanket. Bindja e Evropës, se ndërvarësia ekonomike është garancia më e mirë për paqen, ka rëzuar dhe gabuar.

Evropianët bënë gabim kur e universalizuan përvojën e tyre të pas Luftës së Dytë Botërore në vende si Rusia. Kapitalizmi nuk mjafton për ta zbutur autoritarizmin. Tregtia me diktatorët nuk e bën më të sigurt vendin tuaj, dhe mbajtja e parave të liderëve të korruptuar në bankat tuaja nuk i civilizon ata; përkundrazi ju korrupton ju.

Dhe përdorimi masiv nga Evropa i hidrokarbureve ruse, vetëm sa e bëri kontinentin më të pasigurt dhe më të brishtë. Efekti më destabilizues i pushtimit rus, mund të jetë se fakti që shumë njerëz në mbarë botën po fillojnë të bien dakord me qëndrimin e presidentit ukrainas, Volodymyr

Zelensky.

Gjatë fjalës së tij në forumin e Sigurisë në Mynih në fillimin e shkurtit, ai deklaroi se Kievi kishte gabuar kur ia dorëzoi Rusisë armët bërthamore që trashëgoi nga Bashkimi Sovjetik. Mosgatishmëria e Shteteve të Bashkuara për të mbrojtur një vend mik si Ukraina, mund të bëjë që të paktën disa aleatë të Amerikës, të besojnë se armët bërthamore janë mënyra e vetme për të garantuar sovranitetin e tyre.

Nuk është e vështirë të imagjinohet se po kështu mendojnë edhe fqinjët e Kinës. Fakti që shumica e koreano-juqorëve, janë tani dakord që vendi i tyre të pajset me armë bërthamore, sugjeron se lëvizjet e Vladimir Putinit në Ukrainë, po e vënë në rrezik regjimin botëror të mospërhapjes së armëve bërthamore.

Në vitin 1993, poeti dhe eseisti i madh gjerman Hans Manjus Enzensberger, parashikoi se Lufta e Ftohtë do të pasuhej nga një epokë kaosi, dhune dhe konflikti. Duke reflektuar mbi atë që pa në Jugosllavi dhe trazirat urbane në Shtetet e Bashkuara, ai pa një botë të karakterizuar “paaftësia për të bërë dallimin midis shkatërrimit dhe vetë-shkatërrimit”.

Në këtë botë, “nuk ka më nevojë që të legjitimoni veprimet tuaja, pasi dhuna e ka çliruar veten nga ideologjia”.

Shënim: Ivan Krastev, është anëtar i përhershëm në Institutin për Shkenca Humane në Vjenë, dhe një ekspert i politikës ndërkombëtare.

New York Times – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Sot përballen Teuta - Kamza dhe Ylli - Rahoveci

PRISHTINË, 1 MARS - Në mesjavë zhvillohet xhiroja e 11-të në Ligën Unike, e cila sjell përballje interesante. Takimi i parë zhvillohet në mes të Teutës dhe Kamza Basket. Durrsakët kanë pesë fitore e katër humbje, kurse skuadra nga Kamza ka dy fitore e tetë humbje. Sfidë interesante pritet të zhvillohet ndërmjet rivalëve Golden Eagle Yllit dhe Rahovecit. Therandasit kanë tetë fitore dhe një humbje, kurse Vreshtarët katër fitore e gjashtë humbje. Ylli është në top formë, duke kryesuar në

Ligën Unike dhe Art Motion Superligë, kurse rahovecasit janë përballur me ulje-ngritje gjatë gjithë edicionit. Ndashjet mes këtyre dy skuadrave kanë qenë interesante në vitet e fundit dhe kështu pritet edhe të mërkurën mbrëma. Takim interesant pritet në mes të Pejës dhe Tirana Neptunit. Pejanët kanë shtatë fitore dhe tri humbje në këtë edicion të Ligës Unike, ndërsa tiranasit kanë pesë fitore dhe pesë humbje, andaj pritet një përballje interesante, ku të dyja skuadrat synojnë "play-off"-in dhe të renditen sa më lart në

garat e rregullta. Takimi i fundit i kësaj xhiroje zhvillohet ndërmjet Prizrenit 16 dhe Vllaznisë së Shkodrës. Prizrenasit kanë gjashtë fitore dhe katër humbje, kurse shkodranët dy fitore dhe tetë humbje.

LIGA UNIKE - Java 11

Të mërkurën takohen:
16:00 Teuta - Kamza
17:00 Golden Eagle Ylli - Rahoveci

Të enjten takohen:
17:00 Peja - Tirana
19:00 Prizreni 16 - Vllaznia



Derbi në mes të Flamurtarit dhe Bashkimit në Ligën Unike



Pejë, 1 mars - Në mesjavë zhvillohet xhiroja e nëntë në Ligën Unike të Femrave. Ndashja e parë zhvillohet mes dy skuadrave nga kryeqytetet përkatëse, Partizanit nga Tirana dhe Prishtinës. Vashat e Partizanit kanë dy fitore dhe gjashtë humbje, kurse ato prishtinase katër fitore e tri humbje. Kampionia e Kosovës, Penza, do të takohet me Tiranën. Skuadra nga Peja ka pesë fitore dhe dy humbje,

kurse tiranaset kanë shtatë humbje në shtatë ndeshje të zhvilluara, duke qenë skuadra e vetme pa fitore në Ligën Unike të Femrave. Ndashja zhvillohet mes Flamurtarit dhe Bashkimit, skuadrave që renditen në vendin e parë, përkatësisht të dytë. Skuadra nga Vlora ka gjashtë fitore e një humbje, kurse ajo nga Prizreni ka pesë fitore dhe tri humbje. Takimi pritet të jetë interesant

duke marrë parasysh ambiciet e dy skuadrave që synojnë të fitojnë trofeun e Ligës Unike, në edicionin e parë të zhvillimit.

LIGA UNIKE E FEMRAVE - JAVA 9

Të mërkurën takohen:
17:00 Partizani - Prishtina
19:00 Penza - Tirana

Të enjten takohen:
17:00 Flamurtari - Bashkimi

Batatina: Fokusi i Llapit është te titulli i kampionit

PODUJEVË, 1 MARS - Skuadra e Llapit është futur në një seri fantastike të rezultateve në elitën e futbollit të Kosovës. Tashmë llapjanët janë në garë për titull të kampionit, gjithashtu janë ende në lojë në Kupën e Kosovës. Forma të cilën po e kalon skuadra, si duket, e ka

gëzuar jashtë mase edhe trajnerin e Llapit, Tahir Batatinën, i cili për "Olle" tregoi se nuk ka pasur ndonjëherë atmosferë më të mirë prej se është në krye të Llapit. "Atmosferë më të mirë nuk kam pasur prej se jam trajner i Llapit. Lojtarët mezi presin të vijnë në

seanca stërvitore. Fokusi i Llapit është titulli kampion sepse ne objektivin e Kupës e kemi arritur", ka thënë Batatina, i cili u ka garantuar tifozëve besnikë të Llapit se do ta japin maksimumin. "Legjendave" u garantoj se stafi dhe kryesia së bashku me lojtarët do ta japin

maksimumin që ata t'i bëjmë krenarë dhe qytetin e 'legjendave', ka shtuar Batatina. Pas 22 xhirove në Superligë, Llapi gjendet në vendin e katërt në tabelë me 39 pikë, gjashtë më pak se lideri Ballkani, me të cilin e zhvillon ndeshjen e radhës të dielën në Suharekë.



Zyba rikthehet pas tetë muajsh: Jam i lumtur. Falënderoj Zotin për shëndetin tim



PRISHTINË, 1 MARS - Lajm i mirë për trajnerin dhe tifozët e Prishtinës është rikthimi i mesfushorit Qëndrim Zyba i cili u ka munguar kryeqytetasve për një kohë të gjatë. 21-vjeçari pati pësuar lëndim të rëndë në

ligamentet e gjurit tetë muaj më parë në ndeshjen ndaj Ferencvarosit në Ligën e Kampionëve. Zyba është rikthyer në ndeshjen që Prishtina e ka zhvilluar kundër Gjilanit (2-2). Ai ka thënë se është shumë i

lumtur që është rikthyer sërish për t'i ndihmuar skuadrës. "Shumë i lumtur për rikthimin tim. I falënderohem Zotit për shëndetin që kam. Gjithashtu i falënderohem shumë Qërim Kidës për operimin. Arbanis

Maxhuni, nuk kam fjalë të të falënderoj për punën që ke bërë me mua, për sinqeritetin, dëshirën për rikthimin tim. Ti je njeri me vlera dhe me zemër të madhe. Jemi me fat që të kemi...", ka shkruar Zyba në "Facebook".

Trajneri gjerman largohet nga Lokomotiva Moskë: Nuk punoj në vendin e Putinit

MOSKË, 1 MARS - Trajneri gjerman i Lokomotivës së Moskës, Markus Gisdol, ka dhënë dorëheqje nga detyra e trajnerit të ekipit të Lokomotivës së Moskës. Fillimisht është thënë se arsyeja nuk kishte të bënte me çështje sportive, por vetë

trajneri sqaroi për "Bild" se shkak ishte lufta që Rusia nisi në territorin e Ukrainës. Sipas Gisdol, i cili për herë të parë drejtonte një ekip jashtë vendit të tij, parimet që kishte binin ndesh me atë që po ndodh. "Unë nuk mund të bëj punën time në një vend

ku lideri i saj është përgjegjësi i një agresioni luftime në mes të Evropës. Kjo është kundër vlerave dhe më bën që të jap dorëheqje si trajner i Lokomotivës së Moskës me efekt të menjëhershëm. Nuk mund të qëndroja në qendrën

stërvitore të Moskës, të stërvitja lojtarë dhe të bëja skema taktike ndërkohë që pak kilometra më tej jepen urdhra që të vuajë një popull i tërë. Ky është vendimi im personal dhe jam shumë i bindur për të", është shprehur konkretisht Gisdol.



Rusia dhe Bjellorusia përjashtohen edhe nga hendbolli dhe patinazhi

VJENË, 1 MARS - Bota e sportit po vazhdon ta ndëshkojë Rusinë. Federata Evropiane e Hendbollit vendosi ta përjashtojë Rusinë për sulmin ushtarak ndaj Ukrainës. EHF-ja ka dalë me njoftim zyrtar përmes të cilit njofton se i ka suspenduar Rusinë dhe Bjellorusinë. "Ekipet kombëtare dhe klubet nga Rusia dhe nga Bjellorusia janë suspenduar deri në një njoftim të ri", shkruan në njoftimin e shtëpisë së hendbollit evropian. "Me pamjet e situatës së luftës në Ukrainë dhe me referencën e rekomandimeve nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar, Komiteti Ekzekutiv i Federatës Evropiane të Hendbollit e mori këtë vendim të hënën mbrëma pas mbledhjes së jashtëzakonshme", shkruan tutje në njoftimin e EHF-it. Me këtë rast, Rusia dhe Bjellorusia, si bashkëpunëtorë e saj, nuk do të ftohen në organizimet e ardhshme të hendbollit. Federata Evropiane shpreh keqardhje ndaj sportistëve, klubeve dhe ekipeve kombëtare të Ruisë dhe të Bjellorusisë, ndërkohë që shpreson që rikthimi i



paqes do ta ndryshojë vendimin. Ndërsa edhe Unioni Ndërkombëtar i Patinazhit (ISU) ka njoftuar se i ka përjashtuar patinatorët rusë dhe ata bjellorusë, të cilët nuk do të kenë të drejtë pjesëmarrjeje në garat ndërkombëtare të sportit mbi akull. Ky vendim vjen si rezultat i luftës që e nisi Rusia me Ukrainën. Ekipet kombëtare të Ruisë dhe të Bjellorusisë do të ndalohen të marrin pjesë në garat e sivjetme që do të organizohen nga ISU. Ky i

fundit, përmes një njoftimi zyrtar, e shpreh solidaritetin dhe mbështetjen e pamohueshme për Ukrainën. Gjithashtu, ISU-ja u shpreh e gatshme për të ndihmuar edhe në aspektin humanitar për anëtarët e saj - Ukrainën. Njëjtë si në sportet e tjera, edhe ky institucion theksoi se vendimi do të jetë në fuqi deri në një njoftim tjetër. Paraprakisht, Rusia dhe Bjellorusia u përjashtuan nga sportet si futbollit, basketbolli, hendbolli etj.

Miami fiton duelin e kreut në Lindje, triumfojnë edhe Bucksit dhe Memphisit

MIAMI, 1 MARS - Milwaukee rikthehet te fitorja, duke mundur 130-106 Charlotten, ndeshje e dominuar nga ekipi kampion në NBA. Të gjithë titullarët e Bucksit realizuan mbi 10 pikë, me Antetokounmpou që bëri diferencën me 26 pikë e 16 rebounde. Zhgënjën sërish skuadra e Brooklynit, që në fushën e saj u mund 133-97 nga Toronto. Barnes me 28 pikë e 16



rebounde ishte lider për kanadezët. Miami konsolidon kreun e renditjes në Lindje pas fitores 112-99 ndaj Chicagos, sfida që vuri përballë dy ekipet më të mira në këtë Konferencë. Dallimin e

bënë lojtarët e stolit të Bullsit, që realizuan 49 pikë, ndërkohë që Vincent e Herro realizuan nga 20 pikë secili. Fitoi edhe Memphisit, 118-105 ndaj San Antonios, ndeshje ku u dallua Ja Morant, autor i 52 pikëve.

REZULTATET

Cleveland - Minnesota	122-127
Orlando - Indiana	119-103
Brooklyn - Toronto	97-133
Miami - Chicago	112-99
Memphis - San Antonio	118-105
Milwaukee - Charlotte	130-106
Oklahoma - Sacramento	110-131

SHKURT

Trajneri i Ruisë, mesazh FIFA-s dhe UEFA-s: Kishim një ëndërr, tani e humbëm

Valeri Karpin, trajneri i Përfaqësueses së Ruisë, ka reaguar pas vendimit të FIFA-s që përjashtoi këta të fundit nga Botërori i Katarit. "Është e kotë të themi që jemi të gjithë të zhgënjyer. Sigurisht që prisnim t'i fitonim ndeshjet e 'play-off'. Do të ishim të vendosur në fushë. Është një mëkat për lojtarët të cilët ëndërronin të ishin në Botëror. Tani i kanë humbur të gjithë shpresat. Shpresoj që sanksionet e FIFA-s dhe UEFA-s do të hiqen së shpejti dhe që futbollistët rusë të rikthehen në skenën ndërkombëtare", u shpreh Karpin.

Christianseni është synim i Bayernit dhe Barcelonës

Skuadra e Barcelonës vazhdon t'i ndjekë me vëmendje disa prej lojtarëve që pritet të jenë të lirë në merkaton e verës. Një prej tyre është mbrojtësi i Chelsea, Anders Christiansen. Danezi pritet të largohet në verë dhe me Barçën që po kërkon me ngulm një mbrojtës, ai do të ishte blerja ideale, pasi Barcelona nuk do të shpenzonte asnjë qindarkë. Megjithatë, për Barçën nuk pritet të jetë e lehtë. Sipas medieve gjermane, Bayern Munchenit është gati t'i sfidojë katalanasit për shërbimet e mbrojtësit.

Messi nuk largohet nga PSG-ja

Forma e dobët që Lionel Messi po kalon me skuadrën e PSG-së e ka vënë shumë në diskutim të ardhmen e tij nëse do të vazhdojë të qëndrojë në Paris ose do të largohet. Duket se përgjigjen për të ardhmen e yllit argjentinas e ka dhënë medie spanjolle, e cila ka njoftuar se ylli argjentinas e ka marrë vendimin për të ardhmen. Sipas "El Mundo Deportivo", pavarësisht prej formës së dobët që po kalon Messi, ai do të vazhdojë të qëndrojë në kryeqytetin francez. Gjithashtu, theksohet se dëshira e Messit është që të çojë në finalen e Ligës së Kampionëve ekipin e tij dhe ta ngrejë trofeun më të rëndësishëm në Evropë.

Lewandowski: Jam i hapur për gjithçka

Sulmuesi i Bayern Munchenit, Robert Lewandowski, ka thënë se rinovimi me skuadrën gjigante të Gjermanisë është çështje dytësore. Ai ka bërë me dije se momentalisht është i fokusuar vetëm në lojën e tij, por që ka lënë të nënkuptohet se është i hapur për të gjitha mundësitë. "Jam i hapur për gjithçka. Unë jam i qetë. Është e rëndësishme për mua të jem në gjendje të fokusohem në lojën time. Gjithçka që lidhet me kontratën është çështje dytësore", ishin fjalët e sulmuesit polak, i cili ka kontratë deri në vitin 2023. Bayerni është i interesuar ta mbajë në skuadër sulmuesin polak, kurse interesim për shërbimet e tij ka shfaqur Real Madridi.

Presidenti i Kamerunit emëron trajner të kombëtares ish-mbrojtësin e Liverpoolit

Kameruni me trajner të ri pas dështimit për ta fituar Kupën e Kombeve të Afrikës që e organizoi vetë. Ish-lojtari i kësaj përfaqësueseje, Rigobert Song, është emëruar në këtë detyrë pasi portugezit Toni Conceicao nuk iu rinovua kontrata.

Conceicao i Portugalisë e ka udhëhequr Kamerunin në "play-off" e Kupës së Botës e deri në gjysmëfinale të Kupës së Kombeve të Afrikës muajin e kaluar. Ministrija e Sporteve, Narcisse Mouelle Kombi, ka thënë se presidenti i

Kamerunit, Paul Biya, ka urdhëruar federatën kombëtare të futbollit që t'ia japë detyrën ish-mbrojtësit të Liverpoolit, Song. "Me udhëzimin e presidentit të Republikës, trajneri i ekipit kombëtar të futbollit për meshkuj, Antonio Conceicao,

është zëvendësuar nga Rigobert Song", ka thënë Kombi. "Federata e Futbollit e Kamerunit (Fecafoot) është ftuar t'i marrë masat e nevojshme për një zbatim të shpejtë dhe harmonik të këtyre direktivave shumë të larta".



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 9.2 dhe 15 të Ligjit 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenet 5, 6, 7 dhe 13 të Rregullores (ZKA) 03/2021 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit (shpallur në Gazetën Zyrtare më 16.09.2021), nenit 5 të Rregullores (ZKA) Nr. 02/2021 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në ZKA; Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2022 (i ndryshuar/plotësuar), si Vendimit Nr. 371 të datës 01.03.2022, Zyra Kombëtare e Auditimit, shpall:

KONKURS për plotësimin e vendit të punës

Pozita: Zëvendës Auditor i Përgjithshëm
Numri i referencës: ZAP/ZKA/07-03/22
Grada: ZKA-A1
Numri i pozitave: Një (1)
Kohëzgjatja e emërimit: Me mandat Pesë (5) vjet

Qëllimi i Pozitës:

Zëvendës Auditori i Përgjithshëm është përgjegjës për dhënien e mbështetjes për Auditorin e Përgjithshëm në ushtrimin e mandatit të tij në përputhje me Kushtetutë dhe ligj.

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Zëvendës Auditori i Përgjithshëm, sipas autorizimit ushtron gjitha funksionet dhe kryen të gjitha detyrat dhe kompetencat e AP-së.
- Në mungesë të Auditorit të përgjithshëm, Zëvendës Auditori i Përgjithshëm do të kryejë detyrat e Auditorit të Përgjithshëm në përputhje me ligjin dhe do t'i ketë të njëjtat kompetenca dhe përgjegjësi si të Auditorit të përgjithshëm.

Kualifikimet e kërkuara:

- Diplome fakulteti;
- Tetë (8) vite përvojë në fushën e kontabilitetit, auditimit, financave publike, drejtësisë ose administratës publike;
- Pesë (5) vite përvojë menaxheriale;
- Preferohet të jetë i certifikuar për auditim të jashtëm (auditor i certifikuar ose auditor i certifikuar i sektorit publik);

Shkathësitë e kërkuara:

- Shkathësi të nivelit të lartë në menaxhim, organizim dhe caktim të objektivave;
- Njohuri të shkëlqyeshme për mbikëqyrje efektive të punës profesionale;
- Shkathësi të nivelit të lartë në komunikim dhe negociim;
- Aftësi për të përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e institucionit dhe integritetin e tij;
- Aftësi udhëheqëse, motivuese, dhe komunikuese në menaxhim të performancës;
- Të posedoj aftësi të mira ndër-personale.

Informata të përgjithshme për kandidatë:

Kompensimi i pagës për pozitën e shpallur bëhet në përputhje me aktet e brendshme të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Procedura e Aplikimit:

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:

- Formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Dëshmitë për përgatitjen arsimore dhe përvojën e punës;
- Dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë.

Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen.

Konkursi është i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (online) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit, duke filluar nga data 02.03.2022, kurse afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data 17.03.2022 ora 16.00.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen/shkarkohen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për Administrimin e Dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00. Formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

U skladu sa članom 9.2 i 15 Zakona 05/L-055 o Generalnom Revizoru i Nacionalne Kancelarije Revizije Republike Kosova, i članova 5, 6, 7 i 13 Pravilnika (NKR) 03/2021 o prijemu i Karijeru u Nacionalnoj Kancelariji Revizije (objavljeno u Službenom listu 16.09.2021), član 5 Uredbe (NKR) Br. 02/2021 o Klasifikaciji radnih Mesta u NKR; Godišnjeg plana zapošljavanja za 2022. godinu (izmenjen/dopunjen), i Odluke Br. 371 datuma 01.03.2022.godine, Nacionalna Kancelarija Revizije, objavljuje:

KONKURS za dopunu radnog mesta

Pozicija: Zamenik Generalnog Revizora
Broj reference: ZAP/ZKA/07-03/22
Rang: ZKA-A1
Broj pozicija: Jedna (1)
Trajanje imenovanja: Sa mandatom Pet (5) godina

Svrha pozicije:

Zamenik Generalnog Revizora je odgovoran za pružanje podrške Generalnom revizoru u vršenju njegovog mandata u skladu sa Ustavom i Zakonom.

Dužnosti i Odgovornosti:

- Zamenik Generalnog Revizora, po ovlašćenju vrši sve funkcije i obavlja sve poslove i nadležnosti GR-a.
- U odsustvu Generalnog Revizora, Zamenik Generalnog Revizora će obavljati dužnosti Generalnog Revizora u skladu sa zakonom i imaće ista nadležnosti i odgovornosti kao Generalni Revizor.

Potrebne kvalifikacije:

- Fakultetska diploma;
- Osam (8) godina iskustva u oblasti računovodstva, revizije, javnih finansija, pravosuđa ili javne uprave;
- Pet (5) godina menadžerskog iskustva;
- Poželjno da bude certifikovan za spoljnu reviziju (sertifikovani revizor ili sertifikovani revizor javnog sektora);

Potrebne veštine:

- Visok nivo veština u upravljanju, organizaciji i postavljanju ciljeva;
- Odlično znanje za efikasan nadzor stručnog rada;
- Veštine visokog nivoa na komunikaciji i pregovaranja;
- Sposobnost zastupanja i zaštite interesa institucije i njenog integriteta;
- Veštine vođenja, motivacije i komunikacije u upravljanju učinkom;
- Da poseduje dobre međuljudske veštine.

Opšte informacije za kandidate:

Određivanje plate za objavljenu poziciju se vrši u skladu sa internim pravilima rada Nacionalne Kancelarije Revizije.

Procedura Prijave:

Procedura prijave je otvorena za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa..

Kandidat treba da dostave sledeće potrebne dokumentacije:

- Službeni Formular NKR-a za prijavu;
- Kopiju lične karte Republike Kosovo;
- Dokazi o školskoj spremi i radnom iskustvu;
- Dokaz iz suda da nije pravosnažno osuđen.

Nacionalna Kancelarija Revizije pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i dočekuje kandidate iz svih zajednica na Kosovu. Samo službeni formular za konkurisanje će se uzimati u obzir. Formulari za konkurisanje dostavljeni nakon isteka roka se ne razmatraju a nepotpune će biti odbijene. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume.

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) dana od dana objavljivanja na elektronskim medijama (online) i na internet stranici Nacionalne Kancelarije Revizije, počev od 02.03.2022.godine, dok je rok za podnošenje dokumentacije je 17.03.2022.godine do 16.00 časova.

Obrasci za aplikaciju mogu se preuzeti na recepciji NKR-a ili se mogu preuzeti sa veb stranice NKR-a na adresi www.zka-rks.org i dostavljaju se u Diviziji za administriranje dokumenatima Nacionalne Kancelarije Revizije na adresi: Naselje: Arbëria, ul. "Ahmet Krasniqi" br. 210 – Priština, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00, Obrazac i prateća dokumenta se takođe mogu dostaviti e-poštom na rekrutimi@oagks.org ili preko pošte. Za detaljnije informacije možete se obratiti na br.tel. 038/606-004, ext:1025.

Beleška:

Aplikacije poslate poštom, koje imaju poštanski žig na uručjenju izvršenom poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se validnim i biće uzete u razmatranju.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 145/1
Dt: 01.03.2022

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 8 i Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Neni 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ 05/2021, Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

SHPALLJE E KONKURISIT

Për plotësimin e vendeve të lira në Qendrën e Kompetencës "11 Marsi", në Prizren për vitin shkollor 2022/2023

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i lirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
SHML	Qendra e Kompetencës "11 Marsi"	Prizren	Një mësimdhënës s/e për të nden e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe me 20 orë mësimore;	Zëvendësim deri në kthimin e mësimdhënësve nga pushimi i lehonisë

Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të silltet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkojë apo të pranojë udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPAR-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet për gatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;
- Procedurat e konkurrimit:**
 - Afati i konkurrimit është 7 ditë pas shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës "11 Marsi", në Prizren.
 - Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.
 - Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.
 - Në mungesë të kandidatëve me kualifikim adekuat në intervistë thirren edhe kandidatët me kualifikim të përafërt, në të kundërtën intervistohen vetëm kandidatët me kualifikim përkatës.



Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës
The Trade Union Health Federation of Kosovo
Sindikalna Federacija Zdravstva Kosova

Të nderuar,
Bazuar në nenin 21 paragrafi 3 i Ligjit nr. 04/L-011 gjeni më poshtë informacionet dhe kërkesat për shërbimin në lidhje me auditimin e jashtëm të xhirologarisë kryesore të FSSHK-së si dhe për xhirologaritë e Regjioneve Sindikale, Sindikatën e QKUK-së, Sindikatën e IKSHPK, Sindikatën e EKTGJ, Sindikatën e Stomatologjisë dhe Sindikatën e IML-së.

Organizata:	FSSHK
Tipi i Shërbimit të kërkuar:	Auditimi i jashtëm për vitin 2021
Data e dorëzimit të ofertës financiare dhe dokumentacionit:	7 ditë pas publikimit në shtypin ditor.

Informacion mbi FSSHK-në

Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës – është organizatë përfaqësuese e punëtorëve shëndetësorë në Republikën e Kosovës, e që paraqet organizim sindikal në nivel Federate. Kjo Federatë sindikale në gjirin e saj ka rreth 10 mijë anëtar/e dhe përbëhet prej 49 Shoqatave Sindikale të organizuara nëpër institucione shëndetësore në mbarë territorin e Republikës së Kosovës.

FSSHK-ja, me një strukturë të sofistikuar organizative, ofron përfaqësim dhe mbrojtje dinjtoze për të gjithë anëtarët e saj, dhe ka të shtrirë strukturën e saj në mbarë territorin e Republikës së Kosovës. Selia e FSSHK-së gjendet në kryeqytetin e Kosovës, dhe ka të punësuar stafin profesional, përmes të cilit jep ndihmë profesionale për mbarë anëtarësinë e saj.

FSSHK-ja, si organizatë e pavarur dhe e orijentuar në interesa të veçanta mbi mbrojtjen e të drejtave dhe dinjitetit të punëtorëve shëndetësorë, e organizuar sipas parimeve moderne demokratike, dhe funksionalitet të realizuar përmes organeve vendimmarrëse mbi bazën e vullnetit të anëtarësisë, paraqet asocimin e punëtorëve shëndetësorë në arritjen e qëllimeve të materializuara në harmoni me kërkesat reale të tyre.

Shërbimi i kërkuar

- Auditimi i jashtëm i mjeteve të shpenzuara për vitin fiskal 2021 të përgatitura sipas Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe rregullave të tjera në fuqi në Kosovë.
- Raporti i Auditimit kërkohet të paraqitet në gjuhën Shqipe.

Dokumentacioni që duhet të paraqitet nga Aplikantët

- Licenca e Praktikes se Firmës Ligjore të Auditimit;
- Certifikata e Regjistrimit të Biznesit; numrit fiskal; TVSH-së (nëse jeni deklarues i TVSH-së);
- Historikun e firmës ligjore dhe CV e drejtuesit të saj.
- Do të preferohen firmat e auditimit të cilat kanë së paku 2 vite eksperiencë në auditimin e veprimtarive përkatëse.
- Plani i Punës së Procesit të Auditimit.

Ju lutemi të sillni ofertën financiare së bashku me dokumentacionin e lartpërmendur, jo më vonë se 7 ditë pas publikimit në shtypin ditor, me email në adresën info@fshk.eu ose me postë.

Adresa e Kontaktit:

FSSHK- Rr. Mustaf Kruja V/17-Prishtinë
e-mail: info@fshk.eu
tel: 045/588-902

SHPREHJE INTERESI PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË MARKETINGUT



Me qëllim të ofrimit të shërbimeve të avancuara të marketingut, N.P.K. "Trafiku Urban" SII.A. fton kompanitë e interesuara që të bëhen pjesë e partneritetit për ofrimin e shërbimeve reklamuese përmes zgjedhjeve kreative në autobusët lokal të Trafikut Urban të cilët operojnë në linjat urbane dhe urbane periferike. N.P.K. "Trafiku Urban" SH.A. synon që t'ju ofrojë kushte të barabarta të bashkëpunimit të gjithë operatorëve ekonomik serioz dhe të interesuar, me qëllim që t'ju ofrojë pasagjerëve informata për funksionimin e linjavë të trafikut urban.

Në funksion të realizimit të këtij bashkëpunimi, N.P.K. "Trafiku Urban" SH.A. fton kompanitë e interesuara t'i ofrojnë opsionet për llojet e shërbimeve të tyre në fushën e marketingut. Shërbimet do të precizohen pas propozimeve tuaja dhe pas takimeve të drejtpërdrejta me ju.

Ky është një proces i hapur dhe fillon një ditë pas publikimit të këtij njoftimi dhe vijon me lidhjen e marrëveshjeve të veçanta.

Për të qenë pjesë e këtij partneriteti, fillimisht operatorët ekonomik/kompanitë duhet:

- Të kenë përvojë në veprimtarinë e marketingut së paku tre vite. Si dëshmi mund të përdoret Certifikata e Regjistrimit të Biznesit dhe Informatat e Biznesit;
- Të ketë së paku tre referenca për punën e kryera në fushën e marketingut;
- Të kenë qarkullim vjetor në tre vitet e fundit fiskale (total të deklaruar) afërsisht ose mbi 1,000,000 €. Kjo kërkesë mund të plotësohet nga Operatori Ekonomik vetëm apo në konzorcium. Si dëshmi mund të përdoret gjendja e tatimpaguesit e lëshuar nga autoriteti tatimor, ose Raporti i Auditimit të Pasqyrave Financiare;
- Projektit dhe planin e menaxhimit të tij, duke përcaktuar kohën e projektit, kapacitetet menaxhuese dhe aftësinë për të ofruar përfitime për ndërmarrjen;
- Të posedoj platforma të avancuara teknologjike për ofrimin e shërbimeve të marketingut;
- Të dorëzojnë propozimet e veta, lidhur me idetë që kanë për bashkëpunim, planin menaxherial, konceptet e promovimit si dhe mundësitë për zgjidhjet digjitale të preferueshme.

Të gjitha kërkesat tuaja për të qenë pjesë e këtij partneriteti, së bashku me idetë dhe propozimet (modalitetet) e bashkëpunimit duhet të dërgohen përmes postës elektronike në e-mail adresën info@trafikurban-pr.com

Rr. Tahir Zajmi, Nr. 43, 10000, Prishtinë
Tel: +383 45 10 11 22 | www.trafikurban-pr.com



Duke u bazuar në Nenin 57 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025, operatori i kompanisë "BTP Holding" Sh.p.k. Vushtri, fabrikë për riciklimin e vajrave e yndyrave ushqimore dhe naftës mbeturinë, Banjë, Vushtri, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Aplikacionin për dhënien e Lejes Mjedisore të Integruar
 Njoftohet publiku i interesuar se më datë: 24.03.2022 në ora: 10.00, në hapësirat e Restaurant BTP HOLDING ne adresën Dëshmoret e Kombit , Komuna e Vushtrisë, do të organizohet debat publik nga operatori i kompanisë "BTP Holding" Sh.p.k. Vushtri, fabrikë për riciklimin e vajrave e yndyrave ushqimore dhe naftës mbeturinë, Banjë, Vushtri , në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
 Debatu publik do të organizohet për aplikacionin për dhënien e Lejes Mjedisore të Integruar.
 Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

PROTESTË!

*Protestan, refuzan, mallkuan, penca e shërbimtarët:
 Kurrë burgosjen shërbimtarët, burgosjet edhe
 papullit!*

Kurrë burgosjet UÇK-ja, burgosjet edhe lirin!



"Hero në lehtë, Hero në pagë" - 1



"Drenica para gjyqit" - 2



"UÇK-ja para gjyqit" - 3



"Na e dani Ismaili, Kosovë" - 4



"Edhe malet janë Kosovë para gjyqit, UÇK - 5"



"Mustafa e Kuge-7"

(Këtu janë 7 libra publicistikë, të botuar nga Riza Greçeçevci për Çjykonën Speciale të Hagës, ku po gjykohej: UÇK-ja, çlirimtarët, Drenica, lirin, dëshmorët, pushken e Adem Isahariq, Kosovën...!)

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ N.T.P. "Mozaiku" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 70073273.
- ▶ Palush Maksuti Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I, II, III, të SH. M. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.
- ▶ Teki Dervishaj Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

